

VENDIM
Nr.82, datë 27.1.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1135, DATË 5.8.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit”, e përmendur në pikën 1 të vendimit nr.1135, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, të zëvendësohet me lidhjen, me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pika 1 e vendimit nr.883, datë 22.12.2004 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin e një pjese të punonjësve të Drejtorisë së Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve e të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit

Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi													
Niveli	Grada	Paga bazë për gradë	Në funksione organike për hetimin e krimeve. Oficerët e Policisë Gjyqësore. Kartotekë kërkimi. Policia Shkencore. Gjurmimi teknik. Njësi operative e vëzhgimi. Specialistë të policisë në zonë.	Në funksione të forcës së posaçme dhe oficerë të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda.	Në funksione të sigurisë publike. Policia Rrugore. Qendra e emergjencave e sallave operative. Ruajtja e sigurisë e objekteve.	Në funksione ndalim paraburgimi.	Në funksione organike të Policisë Kufitare & Migracionit	Në funksione operuese të Forcave Speciale (Kom rep, Zv/k rep, shef shtabi në RENE. Reparti i helikopterëve. Njësia antieksplziv. Njësia e negociatorëve & njësia e lëvizshme teritoriale për kufirin e migracionin, si dhe reparti RESI)	Në funksione operuese të Forcat e ndërhyrjes së shpejtë (k.rep/N/rep, Zv.k/rep shef shtabi)	Drejtor zv/drejtor i policisë së qarkut. Shef komisariati. Shef stacioni. Komandant i Rep. të sigurisë së brendshme e ceremonialit.	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë	Në funksione të shërbimit mbështetëse & administrative në Policinë e Shtetit	Në funksione organike drejtor & zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Shtetit. Drejtor i Policisë së Qarkut Tiranë & Drejtoria e Forcave të Lëvizshme Operacionale
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
Niveli zbatues	Nënspektor	32000	650		5500	6500	5500	40000	7000		30000	2000	
	Inspektor	34500	650		5500	6500	5500	40000	7000		30000	2000	
	Kryeinspektor	39000	650		5500	6500	5500	40000	7000		30000	2000	
Niveli i parë drejtues	Nënkomisar	48300	6500	18500	5500		5500	40000	7000	6000	30000	2000	
	Komisar	54250	6500	19500	5500		5500	40000	7000	6000	30000	2000	
	Kryekomisar	80900	6500	22000	5500		5500	40000	7000	6000	30000	2000	15000
Niveli i mesëm drejtues	Drejtuës	92400	6500		5500		5500	40000	7000	6000	30000	2000	15000
	Drejtuës i I-rë	94000	6500		5500		5500	40000	7000	6000	30000	2000	15000
Niveli i lartë drejtues	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm	105000											15000
	Drejtor i përgjithshëm	115000											20000

